



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

Nr. _____ Prot.

Durrës, më _____.2026

NJOFTIM

MBI AFATET DHE PROCEDURAT E LËVIZJES PARALELE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL PËR VITIN 2026

Në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore parauniversitare dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit të punonjësit", më poshtë paraqiten afatet dhe procedurat për lëvizjen paralele të punonjësve të shërbimit psikosocial:

Afatet e procedurës

- **Datë 16.06.2026-25.06.2026:** Dërgohet me postë dosja dhe kërkesa e punonjësit me kontratë pa afat të caktuar.
- **Datë 26.06.2026-30.06.2026:** Bëhet vlerësimi i dosjeve.
- **Datë 01.07.2026-03.07.2026:** Afati për paraqitjen e ankimeve.
- **Datë 08.07.2026:** Shpallja e renditjes përfundimtare.
- **Datë 01.09.2026:** Ofrimi i vendeve vakante.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale - Jetëshkrimi (Curriculum Vitae), sipas Shtojcës 3 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar (*e detyrueshme*).
2. Kërkesë për lëvizje paralele (*e detyrueshme*).
3. Raport mjekoligjor i lëshuar brenda tre muajve të fundit (*i detyrueshëm*).
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës/diplomave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë duhet të paraqitet edhe akti i njohjes/njësimit nga Ministria e Arsimit (*e detyrueshme*).
5. Lista e notave e noterizuar për nivelin Bachelor dhe Master (*e detyrueshme*).
6. Leja për ushtrimin individual të profesionit (licenca), kopje e njehsuar me origjinalin (*e detyrueshme*).
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga aplikanti, sipas Shtojcës 4 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020 (*e detyrueshme*).

8. Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas Shtojcës 5 të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020 (*e detyrueshme*).
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomave të arsimit shtesë, listave të notave, si dhe certifikatave të gjuhëve të huaja ose kualifikimeve të tjera.
10. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (*e detyrueshme*).
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e lëshuar brenda tre muajve të fundit (*e detyrueshme*).
12. Dëshmi penaliteti (*e detyrueshme*).
13. Vërtetim nga institucioni ku ushtron detyrën, që konfirmon se nuk ka masë disiplinore në fuqi (*i detyrueshëm*).

Duke ju uruar suksese në këtë proces, ju falënderojmë për bashkëpunimin.

DREJTOR

HAZBI LIKA